



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 2323 – 5-5-8/C1037
14 Nr. 401/25
Dt. 30.05.2025

KONTRATË FURNIZIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Dauti Komerc “sh.p.k.** ,emri i biznesit, me nr. të ARBK: **810655524**, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson **z. Jetmir Dauti**, në tekstin e mëtejshëm **KONTRAKTUESI – FURNIZUESI**, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi me pemë dhe perime , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	23	2	3	5	5	8
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	3	4	5	5	8

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :
Furnizimi me pemë dhe perime , sipas Përshkrimit të Artikujve dhe Çmimeve si dhe / ose Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-034-558
- 1.2 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data: 30.05.2025 dhe përfundon më së largu deri më dt. 30.11.2025 duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Artikujve dhe Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Furnizuesit) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mund të lejohet një mospërputhje e cila nuk mund të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.
- 1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Artikujve dhe Çmimeve, dhe në rsat të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Menaxheri i Kontratë dhe Komisioni i Pranimit të Mallit nuk duhet të lejojnë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të mallit për atë pozicion ose artikull.

Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të Mallit nuk duhet të lejojnë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të mallit për atë pozicion ose artikull.

- 1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim të mallit të porositur për furnizim do të jetë jo më gjatë se 2 (dy) ditë kalendarike nga koha e lëshimit të Porosisë apo Thirrjes nga ana e Autoritetit Kontraktues apo Organit tjetër të autorizuar.
- 2.2 Kontraktuesi - Furnizuesi duhet që malin e porositur ta dorëzojë në paketim adekuat, ndërsa artikujt duhen ti përmbushin kërkeat lidhur me sasinë, cilësinë e kërkuar si dhe të jenë të pajtim me Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit.
- 2.3 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të liferimit të mallit sipas kësaj Kontrate dhe datës së dërgimit të Porosisë, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
- 2.4 Vendi i dorëzimit të furnizimeve do të jetë depoja qendrore e Njërive Kërkuese të Autoritetit Kontraktues ose vendi të cilin sipas nevojës e cakton Menaxheri i Kontratës i Njësisë Kërkuese të A.K.
- 2.5 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Artikujve dhe Çmimeve e dorëzuar nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: 7,750.20€ (shtatmijshatatqindpesdhjetë/20 Euro) .
- 3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Kontigjentin – mallin e pranuar dhe të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës dhe të konfirmuar me Raportin me shkrim nga Komisioni i Pranimit të Mallit i Autoritetit Kontraktues.
- Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.
- 3.5. Kontraktuesi ka për obligim që malli i porositur respektivisht i liferuar (pemët dhe perimet sipas përshkrimit teknik) të jenë cilësore, ti përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

3.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Furnizuesi të ketë përfunduar gjitha furnizimet e porositura prej Menaxherit të Kontratës – Komisioni i Pranimit të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare ;
- (d) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (e) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.




4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin:

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Jetmir Dauti
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.05.2023	Data:	30.05.2023
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI -- OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr.410/25
Dt. 30.05.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës në zbatim të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës dhe nenit 70 të Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, në bashkëpunim dhe propozim të Njësisë Kërkuese, dhe Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim Publik, më dt. 30.05.2025 merë:

V E N D I M

1. Për Menaxher të kontratës dhe Mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka : Furnizim me pemë dhe perime. " me numër të prokurimit : VU644-25-2323-5-5-8 dhe numër të brendshëm të prokurimit: VU644-25-034-5-5-8 emëroi :

z.Jsuf Gërguri, emërohet menaxher i kontratës.

z.Albanex Tahiraj, emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 70 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon, të

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet , në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj Raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor Administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, Menaxheri i Projektit/Kontratës i Autoritetit Kontraktues duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit/kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i Projektit/Kontratës brenda afatit optimal/të arsyeshëm kohorë, Jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të Kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi /mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të Kontratës të A.K. dhe O.E. – Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të Kontratës, Menaxheri i Projektit do ti lëshoi Op. Ek. – Kontraktuesit Letrën për fillimin e punëve.
- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
 - administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
 - rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.
3. Duke qenë se furnizimet **Furnizim me pemë dhe perime** sipas projektit : **Furnizim me pemë dhe perime** do të pranohen nga secila Njësi Kërkuese, si autoritete shpenzuese, obligoi Menaxherin e Kontratës të dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës, që të kujdesen që, Drejtori i institucionit kerkues të cilit i dedikohet mjeti i punës të emëroj Komisionin " AD HOC " për pranim të mallit në sasi, përshtatshmëri dhe cilësi, sipas Specifikave Teknike të saktësuara në Përshkrimin e Çmimeve, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.
4. Komisioni " AD HOC ", si në pikën 3 të këtij Vendimi, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiorë të furnizimeve sipas Porosive gjegjësisht Kërkesës për furnizime të Njësisë Kërkuese të cilin e përfaqëson , si dhe pranimin e furnizimeve të kryera sipas Porosisë, ku kryes i furnizimeve është Op.Ek.: **Dauti Commerce sh.p.k.,,** me përfaqësues z.Jetmir Dauti , në bazë të kontratës nr. 401/25 të datës 30.05.2025
5. Komisioni " AD HOC " për Pranim të mallit të secilit institucion do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njësisë Kërkuese të Autoritetit Kontraktues.
6. Në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të mallit do të hartojnë Raport Pune në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike, nëse çdo artikull i liferuar respektivisht dorëzuar për pranim, është dorëzuar në përputhje me kontratën dhe Porosinë ose Kërkesën për furnizim.
7. Nëse gjatë procesit të pranimit të mallit konstatohen të meta dhe/ ose parregullsi në cilësi, përshtatshmëri ose sasi të ndonjë artikulli të porositur, Komisioni dhe / ose Menaxheri i Kontratës i A.K. do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive të konstatuara.
8. Nëse gjatë procesit të pranimit të mallit konstatohet se nuk ka të meta, Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të mallit i A.K. do të përpiloj dhe dorëzoj një Raport të veçantë mbi përfundimin e furnizimeve të Porositura, të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës i Njësisë Kërkuese të A.K., në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoj, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.
9. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin me saktësi të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë dhe operatorit ekonomik – Kryesit të furnizimeve, Op.Ek.: **Dauti Commerce sh.p.k.,,** me seli në Prishtinë , sipas planit të përcaktuar dhe aprovuar nga organi kompetent.

Shtojcë : - Kontrata : Nr. 401/25 dt. 30.05.2025

- Përshkrimi i çmimeve i ofertës së Kontraktuesit
- Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës
- dhe dokumente tjera relevante për zbatim të Kontratës

Kopje: Menaxherit të Kontratës;
Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës;
Komisionit për Pranim të Mallit;
Drejtorisë së Prokurimit;
Kontraktuesit


Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia për 6 muaj	Çmimi për njësi DDP-€	Totali i çmimi (DDP-€)
I	FURNIZIMI ME PEMË DHE PERIME				
1	Banane	kg	820.00	1.35	1107.00
2	Kumbulla të fresketa	kg	110.00	1.00	110.00
3	Brokoli	kg	130.00	1.90	247.00
4	Dardha	Kg	230.00	1.50	345.00
5	Domate	Kg	400.00	1.50	600.00
6	Fasule	Kg	730.00	1.70	1241.00
7	Karrota	Kg	212.00	0.60	127.20
8	Kivi	kg	280.00	1.00	280.00
9	Kumbulla	Kg	20.00	1.00	20.00
10	Laker e bardhe e freskët	Kg	450.00	0.50	225.00
11	Laker e kuqe (per sallat)	kg	50.00	0.50	25.00
12	Limon	Kg	90.00	1.00	90.00
13	Mandarina	kg	180.00	1.00	180.00
14	Mollë majoshe	kg	100.00	0.70	70.00
15	Mollë e ëmbel	kg	100.00	0.70	70.00
16	Molla të freskta	kg	520.00	0.70	364.00
17	Molla të gjelbërta	Kg	40.00	0.50	20.00
18	Nektarina	Kg	220.00	1.30	286.00
19	Patate	kg	810.00	0.60	486.00
20	Pjeshka	kg	320.00	0.90	288.00
21	Portokall	Kg	370.00	1.00	370.00
22	Presh (Purri)	Kg	80.00	1.00	80.00
23	Qepë	kg	430.00	0.70	301.00
24	Pjepër jo i terun	Kg	20.00	0.60	12.00

Numri i prokurimit: VU644-22-9535-5-5-8 Titulli : Furnizim me pemë dhe perime

25	Rrush-Dy lloje	Kg	30.00	1.00	30.00
26	Sallata e gjelbert	cope	80.00	0.50	40.00
27	Shalqi	Kg	120.00	0.30	36.00
28	Speca per mbushje	Kg	100.00	1.70	170.00
29	Speca te padjeges	kg	40.00	1.70	68.00
30	Spinaq	kg	20.00	1.00	20.00
31	Tranguj	kg	340.00	1.30	442.00
					7,750.20

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Dauti Komerc SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Jetmir Dauti
NËNSHKRIMI:	
DATA:	24/03/2025
VULA:	



AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRIË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: VU644-25-2323-5-5-8

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Dauti Komerc SH.P.K., Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë

E-mail: kenan.berisha@dauti-ks.com

Personi kontaktues: Kenan Berisha

Telefoni: +383 49947367

Faxi:

Numri fiskal: 810655524

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):